



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac/Municipality of Orahovac

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

Odeljenje za Kulturę, Omladinu i Sport / Department of Culture, Youth and Sport

Nr. l prot. 488
Br. prot. 19-02-25
RAHOVEC - ORAHOVAC

13 Nr. Zyrtar – 2025

Drejtoria e Kulturës, Komuna e Rahovecit, në bazë të rregullores për ndarjen e subvencioneve nga Komuna e Rahovecit, si dhe në bazë të rregullores MF-NR-04/2017 për Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik për OJQ-të, hap:

THIRRJE PUBLIKE - KULTURË

Për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekt propozimeve të, OJQ-ve, shoqatave për organizimin e aktiviteteve Kulturore në Komunën e Rahovecit.

1. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Rahovecit u bënë thirrje të gjitha, OJQ-ve, Shoqatave të regjistruara në Republikën e Kosovës, programi i punës i të cilave është i fokusuar e fushën e kulturës, të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet që kontribuojnë në zhvillimin dhe masivizimin e kulturës, gjithnjë duke u bazuar në politikat programore të DKRS-së, në Komunën e Rahovecit.

2. OJQ-të, shoqatat në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projektet propozimet për organizimin e aktiviteteve Kulturore.

3. OJQ-të, shoqatat- mund të aplikojnë me një projekt që kontribuojnë në organizimin e fushave Kulturore, përmes aktiviteteve si më poshtë:

a) **Festivale:** Art figurativ, artin letrar, muzikë, folklor, vallëzim etj.;

b) **Mbështetje të aktiviteteve vjetore të organizatave kulturore:**

aktivitete mujore, fuqizim i krijuesve të rinj, rezidencë artistike, ligjërata dhe hulumtime;

c) **Muzikë:** kompozim i veprës së re, audio-incizim, koncert, fuqizimi i muzikantëve të rinj, mbështetje të personave me nevoja të veçanta dhe inovacion teknologjik;

d) **Shoqëri kulturore Artistike:** mbështetje të aktiviteteve vjetore, krijimi i koreografive të reja, blerja e kostumeve, blerja e instrumenteve dhe pjesëmarrje në festivale;

e) **Teatër:** Organizimi i shfaqjeve teatrale, promovim dhe pjesëmarrje e shfaqjes në festivale kombëtare, mbështetje të personave me nevoja të veçanta dhe inovacion teknologjik.

f) **Trashëgimi kulturore dhe turizëm:** fushata vetëdijësimi, pjesëmarrje në aktivitete për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, hulumtim, promovim i diversitetit kulturor, turizëm kulturor, platforma informative;

2. Objektivi/objektivat e përgjithshme të kësaj thirrjeje janë që Komuna e Rahovecit të ofrojë përkrahje për OJQ-të, për promovimin dhe afirmimin e turizmit dhe trashëgimisë kulturore, programi i të cilëve është i fokusuar në fushën e kulturës, dhe ofron mbështetjen e tyre me transparencë të plotë dhe pa kurrfarë diskriminimi.

3. Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për një projekt është katërqind euro (400€), ndërsa shuma maksimale për një projekt është njëzet mijë euro (20,000€).

Afati për dorëzimin e projekt propozimeve është nga dt: **19.02.2025 deri me dt: më 12.03.2025**

Periudha e zbatimit të projektit është deri *në fund të muqjit dhjetor 2025*.

4. Kriteret për pjesëmarrje në thirrjen publike të subvencioneve për kulturë:

- Të drejtë aplikimi kanë OJQ-të, të cilat janë të regjistruara në Republikën e Kosovës të cilat aktivitetin e tyre e realizojnë në Komunën e Rahovecit.
- OJQ-të mund të subvencionohen vetëm një herë brenda vitit fiskal nga Komuna e Rahovecit;
- OJQ-të të cilët nuk kanë përmbyllur raportin e subvencioneve të vitit paraprak nuk kanë të drejtë të përfitojnë nga subvencionet e Komunës së Rahovecit në këtë thirrje;
- OJQ-të të cilët nuk kanë pranuar mjete nga burime të tjera të financimit për të njëjtat aktivitete (për të njëjtat linja buxhetore);
- Duhet të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi në mes të aplikuesit, përkatësisht përfaqësuesve/udhëheqësit të aplikuesit dhe organizatës buxhetore apo institucionit publik, siç parashihet me legjislacionin në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesit në Republikën e Kosovës;
- Si dhe kufizimet e tjera të cilat janë parapara me rregulloren për subvencione në Komunën e Rahovecit.

5. Propozimet dhe dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen në objektin e Komunës së Rahovecit, sporteli nr.7, Rr. Dëshmorët e Pashtrikut pn, çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në orën 15:30

- Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë OJQ-të, që janë të regjistruara si OJQ, në regjistrin e organizatave joqeveritare në Republikën e Kosovës, po ashtu OJQ-të të cilat janë të regjistruara në Komunën e Rahovecit, të cilat veprojnë në Republikën e Kosovës, së paku një vit para datës së publikimit të thirrjes publike.
- Aplikacionet, të cilat nuk e kanë dokumentacionin e kompletuar do të eliminohen nga anëtarët e komisionit.
- Dokumentet nuk pranohen pas përfundimit të afatit të thirrjes publike.
- Sjellja e dokumenteve të gabuar ose jo të skanuar mirë, me pamje jo të qartë, konsiderohet si mungesë e dokumentit.
- Nuk do të pranohet ndryshimi i subjektit të aplikantit nga individ në cilindo variant tjetër, pas përfundimit të aplikimit. E njëjta vlen edhe për ndryshim të xhirollogarisë.
- Të gjithë aplikuesit të cilët kanë ndërruar të dhënat e tyre duhet të sigurohen që t'i përditësojnë informatat e tyre në sistem gjatë periudhës së afatit të aplikimit për subvencione.

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë në këtë thirrje publike dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara sinas thirrjes

Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: muharem.a.morina@rks-gov.net, ose në numrin e tel.:+38349483166

Lista e dokumenteve të thirrjes publike:

Certifikata e regjistrimit të OJQ-së;
Certifikata e nr. fiskal;
Vërtetimi/Konfirmimi i llogarisë bankare të OJQ-së (nuk pranohet kopje e kartelës bankare);
Kopjen e letërnjoftimit/ pasaportës të përfaqësuesit të OJQ-së;
Vërtetimin që OJQ/shoqata nuk ka obligime tatimore (nga ATK);
Vërtetimi i DKRS-së, për mbylljen e raportit të vitit paraprak.

> Projekt-propozimet përfshinë: Agjendën, aktivitetet, planifikimi dhe linja buxhetore në harmoni me qëllimin e projektit.

- 1.1 Formulari i aplikacionit (shkarko)
- 1.2 Formulari i buxhetit (sharko)
- 1.3 Formulari i ndarjes buxhetore të projektit (shkarko)
- 1.4 Deklarata e përshtatshmërisë (shkarko)
- 1.5 Deklaratën për financim të dyfishtë (shkarko)

Vërejtje/Kujdes: Të gjitha aplikimet të cilat nuk do të kenë dokumentacionin e kompletuar nuk do të merren parasysh.

Rahovec, shkurt 2025

Drejtori i DKRS-së

